

BASHKIMI
EVROPIAN
I SQARUAR



Dhjetë prioritete për Evropën

Një fillim i ri për Evropën:
Agjendë e BE-së për punësim, zhvillim,
drejtësi dhe ndryshime demokratike



BASHKIMI EVROPIAN I SQARUAR

Ky publikim është pjesë e serisë që sqaron punën e BE-së në fusha të ndryshme të politikave, pse është e përfshirë BE-ja dhe cilat janë rezultatet.

Publikimet mund t'i gjeni këtu:

http://europa.eu/pol/index_en.htm

<http://europa.eu/!bY34KD>

Si funksionon BE-ja

Dhjetë prioritete për Evropën ✕

Themeluesit e BE-së

Bujqësia

Bankat dhe Financat

Kufijnjt dhe siguria

Buxheti

Veprimi klimatik

Konkurrenca

Konsumatorët

Kultura dhe politika audiovizuele

Dogana

Tregu i vetëm digjital

Unioni ekonomik dhe monetar dhe euro

Arsimi, trajnimi,

rinia dhe sporti

Punësimi dhe çështjet sociale

Energjia

Zgjerimi

Mjedisi

Siguria e ushqimit

Çështjet e jashtme dhe politikat e sigurisë

Ndihma humanitare dhe mbrojtja civile

Tregu i brendshëm

Bashkëpunimi dhe zhvillimi ndërkombëtar

Drejtësia, të drejtat themelore dhe barazia

Çështjet detare dhe peshkataria

Migrimi dhe azili

Shëndeti publik

Politika rajonale

Hulumtimi dhe inovacioni

Tatimi

Tregtia

Transporti

PËRMBAJTJA

Dhjetë prioritete për Evropën.....3

Nxitje e re për punësim, rritje dhe investime.....4

Tregu i vetëm digjital i lidhur.....5

Bashkim i qëndrueshëm i energjisë me një politikë largpamëse për ndryshime klimatike.....6

Tregu i brendshëm më i thellë dhe i drejtë me bazë të përforcuar industriale.....7

Union Monetar dhe Ekonomik më i thellë dhe më i drejtë.....8

Marrëveshje e arsyeshme dhe e balancuar e tregtisë së lirë me Shtetet e Bashkuara.....9

Zona e drejtësisë dhe të drejtave themelore bazuar në besim të ndër sjellë.....10

Drejt një politike të re për migrim..11

Aktor i fortë global.....12

Union i ndryshimit demokratik.....13

Mësoni më tepër.....16

BE i sqaruar: Dhjetë prioritete për Evropën

Komisioni Evropian

Drejtoria e përgjithshme për Komunikim

Informimi i qytetarëve

1049 Bruksel

BELGJIKË

A është ky publikim i dobishëm për ju? Na tregoni: comm-publi-feedback@ec.europa.eu

Doracaku u përditësua në muajin tetor 2015

Ballina dhe fotografia në faqen 2: © iStock.com/
DigitalStorm 16 pp. — 21 × 29.7 cm

PDF ISBN 978-92-9238-364-0
doi: 10.2871/671873
JU-02-16-601-SQ-N

Print ISBN 978-92-9238-424-1
doi:10.2871/817749
JU-02-16-601-SQ-C

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2016

© Bashkimi Evropian, 2016

Riprodhimi është i autorizuar. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive, duhet të kërkohet leje e drejtpërdrejtë nga autori.

Dhjetë prioritete për Evropën

Bashkimi Evropian është duke u përballur me sfida të papara duke filluar nga papunësia e lartë, rritja e ngadalte ekonomike, pasiguritë ekonomike dhe boshllëqet e mëdha në investime për shkak të presionit të migrimit dhe sfidave të mjedisit dhe sigurisë, si dhe paqëndrueshmërisë në vendet e saj fqinje. Shumë qytetarë kanë humbur besimin në kapacitetin e institucioneve politike në të gjitha nivelet për trajtimin e këtyre sfidave. Disa nga arritjet e integritimit evropian deri më tani janë në mëdyshje, të tilla si lëvizja e lirë e personave dhe kufijtë e brendshëm të hapur. Popullizmi dhe nacionalizmi janë në rritje.

Në muajin nëntor të vitit 2014, Jean-Claude Juncker u emërua President i Komisionit Evropian, organi ekzekutiv i Bashkimit Evropian. Ai u zgjodh sipas një programi politik, qëllimi kryesor i të cilit është rindërtimi i urave në Evropë dhe kthimi i besimit të qytetarëve evropian, duke i drejtuar politikën e BE-së drejt sfidave kryesore të ekonomisë dhe shoqërisë si dhe forcimin e legjitimitetit demokratik. Për përmbushjen e këtyre sfidave, Jean-Claude Juncker identifikoi 10 prioritetet kryesore që janë përshkruar në këtë broshurë. Ato janë fokusi kryesor për institucionet e BE-së në vitin 2015.



*Jean-Claude Juncker,
President i Komisionit
Evropian duke dhënë fjalimin
në Parlamentin Evropian,
shtator 2015.*

Nxitje e re për punësim, rritje dhe investim

Prioriteti i parë i Komisionit Evropian është zhvillimi/rritja e Evropës dhe rritja e numrit të vendeve të punës pa krijuar borxhe të reja.

Që nga fillimi i krizës globale ekonomike dhe financiare, BE-ja ka pasur nivel të ulët të investimit dhe papunësi të lartë. Për të ndihmuar rikuperimin e ekonomisë së Evropës nevojiten përpjekje kolektive në nivel evropian.

Si rezultat i krizës, pasiguria në parashikimet ekonomike dhe borxhi i lartë publik e privat në një pjesë të BE-së kanë qenë arsyt që i kanë penguar investimet. Megjithatë, ka burime që janë në dispozicion, kështu që paratë duhet të kanalizohen aty ku ka nevojë më së shumti dhe projektet duhet të zhvillohen për përdorim më të mirë të këtyre burimeve.

Komisioni është përqendruar në përdorimin më të mençur të burimeve ekzistuese financiare, duke bërë shfrytëzimin fleksibil të fondeve publike dhe duke përmirësuar cilësinë e rregullores. Komisioni parashih mobilizimin e burimeve publike dhe private të financimit, ku paraja publike është përdorë për gjenerimin e investimeve private shtesë pa krijuar borxh të ri.

Për të siguruar këtë financim shtesë dhe për të synuar projekte me rëndësi strategjike dhe shoqërore, Komisioni, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Investime, kanë nisur planin për investime në Evropë. Në përmbajtje ka një Fond të ri Evropian për Investime Strategjike që është krijuar në një kohë rekorde në vitin 2015, me një shumë fillestare prej 21 miliardë euro nga paratë e BE-së. Kjo do të rritet në sajë të një efekti të shumëfishtë, duke krijuar investime të tjera prej më shumë se 315 miliardë euro. Kjo mund të krijojë 1.3 milion vende pune në 3 vitet e ardhshme. Një e katërta e parave do të investohen në biznese të vogla.

Të gjitha vendet e BE-së kanë miratuar fondin dhe mund të kontribuojnë në të. Deri në tetor të vitit 2015, nëntë shtete anëtare, tashmë kanë premtuar të kontribuojnë më një shumë prej 40 miliardë euro. Gjithashtu edhe Kina ka treguar synimin e saj për të kontribuar.

Investimet do të përqendrohen në:


- infrastrukturë — brezin e gjerë, rrjetet të energjisë dhe transport;
- edukim, hulumtim dhe inovacion;
- energji të ripërtëritshme dhe eficientë të energjisë;
- projekte për të ndihmuar të rinjtë të gjejnë punë.

Financimi do të kanalizohet në projekte që janë praktike dhe sjellin dobi për shoqërinë e gjerë. Është identifikuar një listë e projekteve që mund të zbatohen gjatë 3 viteve të ardhshme dhe barrierat që pengojnë investimet.

Prioritet do t'i jepet heqjes së barrierave të rëndësishme rregullatore dhe jorregullatore, të cilat mbeten në të gjithë sektorët kyç të infrastrukturës, duke përfshirë energjinë, telekomin, digjitalizimin, transportin, si dhe barrierat në shërbime dhe tregjet e produkteve. Komisioni ka propozuar një listë të plotë të nismave në programin e tij të punës për vitin 2015.

Ambienti rregullator ka ndikim direkt në investime, rritje dhe punësim. Mbyllja e boshllëqeve në treg mund të prodhojë përfitime në vlerë prej 1 500 miliardë euro në vit, duke shfrytëzuar potencialin e plotë të rritjes së tregut të vetëm me shtimin e më shumë se 11 % të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

RRITJA NË PBB
PBB REAL PËR 28 SHTETE TË BE-SË; INDEKSI 2007=100



Ekonomia e BE-së ka qenë në krizë qysh nga viti 2008 deri në vitin 2014, por ka mundësi të rikuperohet me investime të reja.

Tregu i vetëm digjital i ndërlidhur

Komisioni dëshiron që të gjithë të kenë qasje më të mirë të mallrave dhe shërbimeve digjitale, në infrastrukturën e besueshme me shpejtësi të lartë dhe për të marrë maksimumin e ekonomisë digjitale.

Interneti dhe teknologjia digjitale po e transformojnë botën. Evropa duhet të hapë mundësi digjitale për njerëzit dhe bizneset. Aktualisht, barrierat në internet nënkuptojnë që qytetarët humbin mundësitë e blerjes së mallrave dhe shërbimeve: vetëm 15 % e qytetarëve të BE-së blejnë në internet nga një vend tjetër i BE-së. Kompanitë e internetit dhe bizneset fillestare nuk përfitojnë plotësisht nga mundësitë e rritjes në internet: vetëm 7 % e bizneseve të vogla shesin përtej kufirit. Bizneset dhe qeveritë nuk përfitojnë plotësisht nga mjetet digjitale.

Një treg i vetëm digjital që është tërësisht funksional do të kontribuonte me 415 miliardë euro për një vit në ekonominë e BE-së dhe do të krijonte 3.8 milion vende pune.

Strategjia për tregun e vetëm digjital e propozuar nga Komisioni në muajin maj të vitit 2015, përmban një sërë veprimesh që duhet të arrihen deri në fund të vitit 2016. Këto përfshijnë si në vijim.

• **Ofrimi i qasjes më të mirë në internet për mallrat dhe shërbimet digjitale me:**

- ▶ harmonizimin e rregullave të BE-së për kontratat dhe mbrojtjen e konsumatorit gjatë blerjes online, qoftë për mallra fizike të tilla: si këpucë e mobilie ose përmbajtje digjitale si e-libra dhe aplikacione;
- ▶ promovimin e shërbimeve më të lira të dërgimit ndërkufitar të dërgesave: 62 % e kompanive që duan të shesin përmes internetit, ankohen për kosto të lartë të dërgimit, e cila paraqet pengesë të madhe;
- ▶ përfundimin e gjeo-blokimeve të paarsyetuara — një praktikë diskriminuese ku shitësit online ose ua mohojnë konsumatorëve t'i qasen një faqeje interneti në bazë të vendndodhjes së tyre, ose i transferojnë ata në një tjetër faqe që kanë çmime të ndryshme. Një bllokim i tillë nënkupton, për shembull, konsumatorët e makinave me qira në një vend të BE-së mund të paguajnë më shumë për një makinë me qira që është identike në të njëjtin vend krahasuar me konsumatorët e një vendi tjetër të BE-së;
- ▶ modernizimin e ligjit për të drejtën e autorit për të lejuar qasje të gjerë në internet të veprave kulturore në të gjithë BE-në. Në veçanti, Komisioni dëshiron të sigurojë që përdoruesit të cilët blejnë filma, muzikë ose artikuj në vendin e tyre mund t'i shfrytëzojnë ato edhe gjatë udhëtimit nëpër Evropë;

KU I BLEJMË SHËRBIMET NË INTERNET?



- ▶ ofrimi i shpejtësisë së lartë, infrastrukturë të sigurt dhe të besueshme të mbështetur nga kushte të duhura rregullative për investime, konkurrencë të drejtë dhe një fushë të barabartë të lojës.
- **Hyrja në një kontroll ambicioz të rregullave të për telekome:** të gjitha shërbimet digjitale, aplikacionet dhe përmbajtjet varen nga disponueshmëria e shpejtësisë së lartë dhe infrastruktura e sigurt. Këtu kërkohet sektor i fuqishëm, konkurrues dhe dinamik i telekomeve. Duhet ndërmarrë veprime për të trajtuar çështjen e tregjeve të izoluara edhe përbrenda kornizave kombëtare.
- **Maksimizimin e potencialit të rritjes së ekonomisë digjitale.** Kjo do të arrihet nga investimet në infrastrukturën e TIK-ut, për shembull, kompjuterizimi me cloud dhe përdorimi i 'të dhënave të mëdha', si dhe hulumtimi e novacioni me qëllim të rritjes së konkurrencës industriale. Do të përfshihen gjithashtu shërbime më të mira publike dhe shkathtësi të përmirësuar digjitale për qytetarët – me pak fjalë, një 'shoqëri gjithëpërfshirëse'.

Bashkim i qëndrueshëm i energjisë me një politikë largpamëse për ndryshime klimatike

Komisioni dëshiron të sigurojë energji të sigurt, të përbalueshme dhe miqësore ndaj klimës për qytetarët dhe bizneset. Përdorimi më i mençur i energjisë dhe luftimi i ndryshimeve klimatike nuk është vetëm një investim për të ardhmen e fëmijëve tanë, por gjithashtu krijon vende të reja pune dhe rritje.

Sistemi evropian i energjisë përballet me një nevojë urgjente për të siguruar energji të sigurt, të qëndrueshme, të përbalueshme dhe konkurruese për të gjithë qytetarët. Varësia e tepërt në një numër të kufizuar të burimeve të furnizimit i lë vendet të cenueshme ndaj ndërprerjes së furnizimit. BE-ja duhet të zvogëlojë varësinë e saj nga lëndët djegëse fosile ta ulë emetimin të gazeve serrë, duke siguruar që familjet dhe bizneset të pajisen me energji të përbalueshme. BE-ja përballet me shumë sfida në arritjen e kësaj.

- BE-ja është importuesi më i madh i energjisë në botë, që importon 53% të energjisë së saj me një kosto vjetore rreth 400 miliardë euro.
- Shumë rrjete elektrike dhe tubacione të gazit janë ndërtaur për qëllime kombëtare dhe nuk janë të lidhura mirë edhe përtej kufijve. Për shembull, deri në vitin 2015, kablloet e energjisë elektrike që lidhin Francën dhe Spanjën mund të përballonin vetëm 3% të pikut në jug të kufirit. Rregullimi i problemeve si këto mund t'u kursejë konsumatorëve deri në 40 miliardë euro për një vit.

75% e shtëpive tona kanë energji joefikase; 94% e transportit mbështetet në produktet e naftës, nga të cilat 90% importohen.


Në muajin shkurt të vitit 2015, Komisioni ka përcaktuar strategjinë për arritjen e një unioni të qëndrueshëm të energjisë me një politikë largpamëse të ndryshimeve klimatike. Kjo strategji do të sigurojë që BE-ja është e gatshme t'i tejkalojë sfidat në bazë të solidaritetit dhe besimit në mes të shteteve anëtare. Strategjia fokusohet në pesë fusha kyçe.

• **Furnizime të sigurta:** BE-ja duhet të bëhet më pak e varur nga energjia jashtë kufijve të saj. Kjo nënkupton përdorimin më efikas të burimeve tona të brendshme të energjisë, përmes diversifikimit të burimeve dhe furnizimeve të tjera.

• **Tregu i brendshëm i energjisë:** energjia duhet të qarkullojë lirishëm në të gjithë BE-në, pa asnjë pengesë teknike ose rregullatore.

Vetëm atëherë ofruesit e energjisë mund të konkurrojnë lirshëm dhe të ofrojnë çmime më të mira të energjisë. Qarkullimi i lirshëm

PREJ NGA VJEN ENERGJIA JONË?



Evropianët kanë nevojë për burime më të sigurta dhe të qëndrueshme të energjisë.

do të lehtësonte gjithashtu edhe prodhimin më të madh të energjisë së ripërtëritshme.

• **Efikasiteti i energjisë:** më pak konsumim i energjisë, nënkupton më pak ndotje dhe ruajtje më e madhe e burimeve tona të brendshme të energjisë, zvogëlim i nevojave tona për import të energjisë.

• **Reduktimi emetive:** objektivi i BE-së i rënë dakord për emetimin e së paku 40% më pak të gazeve deri në vitin 2030 është një hap fillestar. Kjo nënkupton që ne duhet të investojmë më shumë në zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme..

• **Hulumtim dhe inovacion:** duke pasur rol udhëheqës teknologjik në fushën e energjisë alternative dhe me reduktimin e konsumimit të energjisë do të rritet eksporti dhe mundësitë industriale. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në nxitjen e rritjes dhe vendeve të punës.

Strategjia shoqërohet me një plan veprimi që paraqet masa të veçanta që do të përgatiten dhe zbatohen gjatë viteve të ardhshme. Në muajin korrik, Komisioni paraqet propozimet për ofrimin e një marrëveshjeje të re për konsumatorët e energjisë, për nisjen e një ridizajnimi të tregut evropian të energjisë, për përditësimin e etiketimit të efikasitetit të energjisë dhe për rishikimin e sistemit të emetimeve tregtare të BE-së.

Literaturë shtesë dhe zhvillimet e fundit

http://ec.europa.eu/priorities/energy-union/index_en.htm

Treg i brendshëm më i thellë dhe më i drejtë me bazë të përforcuar industriale

Një ekonomi e integruar e BE-së është mënyra më e mirë për përmbushjen e sfidave të globalizimit. BE-ja ka nevojë për përfundimin e tregut të brendshëm për produktet dhe shërbimet dhe të mundësojë një platformë që kompanitë dhe industrinë të kenë sukses në ekonominë globale. Kjo krijon rritje dhe vende pune. Përmirësimi i tatimit të drejtë, efikas, miqësor ndaj rritjes dhe transparencës është pjesë e këtij prioriteti.

Prioritetet e Komisionit janë:

- Krijimi i një unioni të tregjeve të kapitalit, duke e bërë më të lehtë për bizneset e vogla të rrisin të ardhurat dhe të bëjnë Evropën një vend më tërheqës për investim;
- nkurajimi i punëtorëve që të punësohen në vende të tjera të BE-së në mënyrë që të plotësohen vendet e lira të punës dhe të përmbushen nevojat për shkathtësi të veçanta;
- Parandalimi i dampingut social;
- Nxitja e bashkëpunimit administrativ ndërmjet autoriteteve kombëtare tatimore;
- Puna për miratimin e një baze të përbashkët të konsoliduar të taksave të korporatave dhe taksës për transaksionet financiare në nivel të BE-së.

Në shtator të vitit 2015, pas një konsultimi publik, Komisioni ka miratuar një plan veprimi që përcakton 20 masa të rëndësishme për të arritur një treg të vërtetë të vetëm të kapitalit në Evropë. Ky projekt synon të zhbllokojë fondet për bizneset e Evropës dhe nxitjen e rritjes në BE. Qëllimi është që kjo të arrihet deri në vitin 2019.


Lëvizja e lirë e kapitalit është objektiv i përhershëm i Bashkimit Evropian. Megjithatë, tregjet e kapitalit të Evropës, mbeten të fragmentuara përgjatë vijave kombëtare, ndaj ekonomitë evropiane mbeten shumë të varura nga bankat sa i përket nevojave të tyre për financim. Kjo i bën ata më të prekshëm në kohët e recesionit me shtrëngim të kredihënies bankare. Në pjesë të tjera të botës është më e zakonshme që investitorët të ofrojnë direkt të ashtuquajturat 'sipërmarrje kapitali' për kompanitë e reja.

Unioni i tregjeve të kapitalit ka për qëllim largimin e pengesave që po bllokojnë investimet ndër-kufitare në BE dhe po i parandalojnë bizneset nga qasja në financa. Për shembull, në qoftë se tregjet e "sipërmarrje-kapitali" të BE-së do të funksionin si ato të Shteteve të Bashkuara, 90 miliardë euro shtesë do të mund të investoheshin në kompani në mes të vitit 2008- dhe 2013.

Në qershor të vitit 2015, Komisioni paraqiti një plan veprimi për të reformuar rrënjësisht tatimin e korporatave në BE. Aty përcaktohen një sërë iniciativash për trajtimin e shmangies së taksave, sigurimi i të hyrave të qëndrueshme për financimin e shërbimeve publike dhe forcimin e tregut të vetëm për bizneset. Plani i veprimit përmban dy qëllime kryesore:

- Shtetet Anëtare të BE-së duhet të bien dakord për rregullat e përbashkëta se si të llogaritet baza e tatimeve të biznesit. Kjo do ta bënte shumë më të lirë që bizneset të operojnë përtej kufijve dhe të zvogëlojnë shmangien nga taksat duke lejuar shtetet e ndryshme anëtare të mbajnë norma të ndryshme tatimore për korporatat;
- Profitet duhet të taten aty ku krijohen e jo në bazë të strukturave të biznesit formal apo transaksioneve kontabël të kryera për qëllime tatimore.

KAPITALIZIMI I TREGUT TË AKSIONEVE NË BE (VLERA E TË GJITHA AKSIONEVE) NË % TË BPV



Tregjet e kapitalit në BE, kanë pasur probleme pas krizës financiare.

Unioni Monetar dhe Ekonomik më i thellë dhe më i drejtë

Për trajtimin e krizës ekonomike, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare ndërmorrën masa të guximshme dhe të papara që nuk ishin gjithmonë të lehta, sidomos për qytetarët, dhe se nganjëherë nuk kanë marrë mjaftueshëm parasysh pasojat e tyre sociale. Tani është koha që të shfrytëzohen mësimet e nxjerra për një qeverisje të përmirësuar ekonomike dhe të fillohet kompletimi i Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU) bazuar në 'Raportin e Pesë Presidentëve' nën udhëheqjen e Presidentit Juncker.

EMU ishte një hap i rëndësishëm për integrimin e ekonomive të BE-së. Ajo përfshinë koordinimin e politikave ekonomike dhe fiskale, një politikë të përbashkët monetare dhe valutën e përbashkët- euro. Përderisa të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së, marrin pjesë në unionin ekonomik, disa shtete e kanë çuar integrimin më tej duke e adoptuar euron. Integrimi ekonomik sjell përfitime më të mëdha dhe efikasitet të brendshëm për ekonominë e BE-së si tërësi si dhe të ekonomive të shteteve anëtare veç e veç. Kjo, nga ana tjetër, ofron mundësi për stabilitet ekonomik, rritje më të lartë dhe më shumë vende pune— rezultate të përfitimit të drejtpërdrejtë për qytetarët e BE-së.

Që nga fillimi i krizës financiare dhe ekonomike në tetor të vitit 2008, BE ka ndërmarrë masa për të siguruar:

- **mbështetje ekonomike** për vendet e BE-së të cilat janë goditur rëndë nga kriza, të kombinuara me marrëveshje mbi reformat. Shumica e këtyre programeve të asistencës kanë përfunduar me sukses në vitin 2014, ndërsa gjendja në Greqi ka kërkuar marrëveshje të reja në vitin 2015;

- **rivendosja e stabilitetit financiar** dhe krijimi i kushteve të duhura për rritje dhe krijim të vendeve të punës. Tani ka rregulla të përbashkëta se si të mbikqyren bankat dhe të ndihmohen bankat kur janë në vështirësi;

- sistem më i mirë i BE-së për **qeverisje** më të mirë ekonomike dhe financiare. Të gjitha vendet e BE-së tani diskutojnë dhe analizojnë buxhetin publik së bashku.

Objektivat kryesore të Komisionit për përmirësim janë si më poshtë:

- marrja e vendimeve në lidhje me ofrimin e mbështetjes për tejkalimin e vështirësive të vendeve të eurozonës në mënyrë më demokratike dhe legjitime, me ngritje të kontrollit parlamentar në BE dhe në nivel kombëtar;

- vlerësimi i programeve të BE-së për mbështetje dhe reforma, jo vetëm për mënyrën se si ato ndihmojnë në krijimin e financave të qëndrueshme, por edhe për ndikimin e tyre në qytetarët e vendit në fjalë;

PRIORITETET E POLITIKËS EKONOMIKE: TRI SHTYLLA



- rishikimi i rregullave se si BE-ja monitoron situatën fiskale dhe makroekonomike dhe buxhetet kombëtare;

- nxitja e reformave të mëtejshme strukturore në zonat e euros.

Në shkurt të vitit 2015, Komisioni prezantoi një analizë të Udhëheqësit të Shteteve dhe Qeverive për të metat kryesore të EMU që kanë dalë në pah si rezultat i krizës. Si rezultat, në muajin qershor, janë shpallur plane **ambicioze se si të thellohet EMU dhe si të përfundohet më së voni deri në vitin 2025** nga Presidenti i Komisionit në bashkëpunim të ngushtë me presidentët e euro samitit, Eurogrupin (ministrat e Shteteve Anëtare në zonën e euros), Bankën Qendrore Evropiane dhe Parlamentin Evropian (i ashtuquajturit Raporti i 'Pesë Presidentëve'). Masat e propozuara përfshijnë futjen e një skeme evropiane të sigurimit të depozitave dhe krijimin e një thesari të zonës euro.

Marrëveshje e arsyeshme dhe e balancuar e tregtisë së lirë me Shtetet e Bashkuara

Momentalisht, Komisioni Evropian është duke negociuar një marrëveshje tregtare me Shtetet e Bashkuara. Qëllimi është hapja e tregtisë dhe investimeve sa më shumë që është e mundur në mes të dy blloqeve. Kjo do të sjellë më shumë vende pune dhe rritje në të dyja anët.

BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara, së bashku përbëjnë 40 % të prodhimit ekonomik global. Një Partneritet i gjerë Transatlantik për Tregti dhe Investime (TTIP) mund të sjellë përfitime të rëndësishme ekonomike, zgjedhje më të gjera për konsumatorët dhe mundësi të reja për bizneset. TTIP do të forconte gjithashtu edhe pozitën strategjike të BE-së në botë.

Marrëveshja ka të bëjë më shumë se vetëm me heqjen e tarifave. Tarifat në mes të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara tashmë janë të ulëta (mesatarisht vetëm 4 %), pra pengesat kryesore të tregtisë shtrihen në rregulloret 'pas kufijve', barrierat jo-tarifore dhe në shiritin e kuq. Vlerësimet tregojnë se 80% e fitimeve të përgjithshme të mundshme të pasurisë nga një marrëveshje tregtare vijnë nga ulja e kostove administrative dhe nga liberalizimi i tregtisë në shërbime dhe prokurim publik.

Me TTIP, Komisioni dëshiron t'i ndihmojë njerëzit dhe bizneset përmes:

- **hapjes së tregjeve të Shteteve të Bashkuara** për kompanitë e BE-së, përfshirë edhe shërbimet publike;
- ndihmës në prerjen e **shiritit të kuq** me të cilin kompanitë përballen gjatë eksportit;
- vendosja e **rregullave të reja** për ta bërë **eksportin**, importin dhe **investimin** jashtë shtetit më **të lehtë** dhe **të drejtë**.

TTIP do të ndihmojë kompanitë evropiane të shesin më shumë mallra dhe shërbime në Shtetet e Bashkuara. Kompanitë evropiane gjithashtu mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në tenderët qeveritar të Shteteve të Bashkuara. Kjo do të ishte mirë për ekonominë dhe punësimin.


Në Evropë, importet më të lira amerikane nënkuptojnë më shumë zgjedhje në dyqane me çmime më të ulëta: mallrat dhe shërbimet më të lira do të sjellin kursime për bizneset.

Komisioni do të negociojë një marrëveshje tregtare të arsyeshme dhe të balancuar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Komisioni mbështet tregtinë e lirë, por jo me çmimin që të sakrifikohen standardet evropiane në fushat siç janë: siguria e ushqimit, shëndeti, mbrojtja sociale dhe e të dhënave ose diversiteti kulturor.

Në shtator, Komisioni propozoi një sistem të ri dhe transparent për zgjidhjen e kontesteve në mes të investitorëve dhe shteteve – sistemin e gjykatave për investime. Kjo do të zëvendësonte mekanizmin ekzistues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes investitorëve dhe shteteve (ISDS), në të gjitha negociatat aktuale dhe të ardhshme të investimit nga BE-ja, përfshirë TTIP.

Parlamenti Evropian, i cili zgjedhet nga qytetarët e BE-së, do të ketë fjalën e fundit nëse ajo marrëveshje është e pranueshme.

TTIP: MARRËVESHJE E RE MES BE-SË DHE SHBA-VE



Tregtia në mes të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara tashmë e ka vlerën e qindra miliarda eurove në vit, dhe ka gjasa që kjo të shënoj rritje të mëtejshme përmes një marrëveshjeje të re për tregti të lirë.

Zona e drejtësisë dhe të drejtave themelore bazuar në besim të ndërsjellë

BE-ja nuk është thjeshtë një treg i përbashkët për mallra dhe shërbime. Bazohet në vlerat e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Komisioni nuk do të lë në harresë këto vlera në përpjekjet e tij për luftimin e terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandës dhe krimin kibernetik.

Objektivat kryesore të Komisionit janë:

- t'u lehtësohet qytetarëve dhe kompanive në BE të mbrojnë të drejtat e tyre jashtë vendit të tyre amë duke përmirësuar njohjen e ndërsjellë të vendimeve nga ana e gjykatave në të gjithë BE-në;
- goditja e krimin të organizuar, i tillë si trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda dhe krimi kibernetik, dhe luftimi i korrupsionit;
- përfundimi i anëtarësimit të BE-së në Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut;
- marrja e garancive se agjencitë qeveritare dhe kompanitë e Shteteve të Bashkuara mbrojnë në mënyrë të duhur të dhënat personale të qytetarëve të BE-së.

Në prill të vitit 2015, Komisioni Evropian përcaktoi një agjendë evropiane për sigurinë në mbështetjen e bashkëpunimit të shteteve anëtare në trajtimin e kërcënimeve të sigurisë dhe rritjen e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit, krimin të organizuar dhe krimin kibernetik. Agjenda përcakton mjetet konkrete dhe masat të cilat do të përdoren për të garantuar sigurinë dhe trajtimin efikas të këtyre tri kërcënimeve më të theksuara.

Veprimet kryesor përfshijnë:


- luftimin e radikalizmit:** Komisioni do të krijojë një qendër të përsosmërisë për mbledhjen dhe shpërndarjen e ekspertizës për anti-radikalizëm;
- ndërprerja e financimit të kriminelëve:** bashkëpunimi në mes të autoriteteve kompetente në Evropë do të forcohet. Kjo përfshinë, në veçanti, njësitë kombëtare të inteligjencës financiare, të cilat do të jenë të lidhura me Europolin;

- përmirësimi i dialogut me industrinë e TI:** në vitin 2015, Komisioni do të fillojë një forum të BE-së me kompanitë më të mëdha të TI në mënyrë që t'i kundërvihen propagandës terroriste në internet dhe në mediat sociale dhe për të eksploruar mënyrat për të adresuar shqetësimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit në teknologjitë e reja të enkriptimit;
- përforcimi i mjeteve për luftimin e krimin kibernetik:** prioriteti është identifikimi i mënyrave të kapërcimit të pengesave në hetimet kriminale në internet, sidomos në çështjet kompetente, dhe rregullat për qasje në provat dhe informacionin e bazuar në internet;
- përmirësimi i kapaciteteve të Europolit,** përfshirë krijimin e një qendre evropiane kundër terrorizmit, që do të ndihmojë Europolin për të rritur mbështetjen për veprimet e ndërmarra nga autoritetet kombëtare të zbatimit të ligjit për trajtimin e luftëtarëve të huaj terrorist, financimin e terrorizmit, përmbajtjet e dhunshme të ekstremizmit në internet, dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit.

CILAT PYETJE TË SIGURISË SË BRENDSHME JANË MË TË RËNDËSISHMET PËR EVROPIANËT?

Eurobarometri i sondazhit të opinionit publik mars 2015; i përgjigjet pyetjes:

'Sipas mendimit tuaj, sa janë të rëndësishme sfidat e mëposhtme për sigurinë e brendshme të BE-së?



Qytetarët janë të brengosur për terrorizmin dhe krimin e organizuar.

Literaturë shtesë dhe zhvillimet e fundit

http://ec.europa.eu/priorities/justice-fundamental-rights/index_en.htm

Drejt një politike të re për migrimin


Bota është e tronditur nga gjendja e vështirë e mijëra emigrantëve që kanë vënë jetën e tyre në rrezik për të hyrë në BE. Asnjë vend i BE-së nuk mund dhe as që duhet të përballet e vetme me presionet e mëdha migruese. BE-ja po rritë përpjekjet e saja për të shpëtuar jetë, për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të bashkëpunuar me vendet e origjinës dhe tranzitit. Edhe më thellësisht, Komisioni do të trajtojë shkaqet themelore që detyrojnë njerëzit të ikin dhe migrojnë: varfëria, luftërat, përndjekjet, shkelja e të drejtave të njeriut dhe fatkeqësitë natyrore.

Rritja e papritur e numrit të njerëzve, të cilët janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për t'i shpëtuar dhunës dhe të kërkojnë strehim në vendet e tyre apo jashtë vendit, është një test për Bashkimin Evropian. Përgjigja e Evropës në muajt e fundit ka qenë gjithëpërfshirëse dhe vendimtare:

- një shtesë prej 1.7 miliardë euro janë vënë në dispozicion në muajin shtator, duke çuar buxhetin e përgjithshëm të BE-së për trajtimin e krizës së refugjatëve në 9.2 miliardë euro në vitin 2015 dhe 2016;
- BE-ja është donatori numër një në përpjekjet globale për të lehtësuar krizën e refugjatëve sirian. Rreth 4 miliardë euro janë dhënë nga Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare për t'i dalë në ndihmë sirianëve në vendin e tyre dhe refugjatëve;
- shtetet anëtare kanë rënë dakord që të zhvendosin 160 000 njerëz që janë në nevojë të qartë për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetet anëtare më të prekura në shtetet e tjera anëtare. Poashtu 22 000 refugjatë do të zhvendosen nga kampet jashtë BE-së;
- është trefishuar prania në det që nga muaji maj. Mbi 122 000 jetë janë shpëtuar që nga ajo kohë;
- janë dyfishuar përpjekjet për trajtimin e kontrabandistëve dhe shpërbërjen e grupeve për trafikimin e njerëzve.

Në një studim të bërë së fundi të opinionit publik në BE, 73% e evropianëve kanë thënë se janë në favor të një politike të përbashkët evropiane për migrim. Kur u pyetën për të identifikuar dy shqetësimet më të mëdha me të cilat përballet BE-ja, çështja e migrimit ishte në krye të listës para situatës ekonomike dhe papunësisë. Ishte shqetësimi më i shpeshtë i përmendur në 20 nga 28 shtetet anëtare.

NUMRI I APLIKIMEVE PËR AZIL NË BE



Shifrat preliminare për gjashtë muajt e parë të vitit 2015 janë 402 000

Rritja e numrit të njerëzve që dojnë azil në BE bën thirrje për zgjidhje të përbashkëta evropiane.

Ndërsa kriza e refugjatëve ka vënë në qendër të vëmendjes nevojat e menjëhershme dhe paraqet prioritet të lartë aktual, gjithashtu ka zbuluar shumë edhe për kufizimet strukturore të politikës së migrimit të BE-së dhe për mjetet në dispozicionin e saj. Me Agjendën Evropiane për Migrim të paraqitur nga Komisioni në muajin maj të vitit 2015, është përcaktuar një qasje gjithëpërfshirëse për ndërtimin e menaxhimit të migrimit në katër shtylla:

- zvogëlimi i stimujve për migrimin e parregullt;
- shpëtimi i jetëve dhe sigurimi i kufijve të jashtëm;
- një politikë e fuqishme e përbashkët e azilit;
- një politikë e re për migrimin e ligjshëm.

Akter më i fortë global

Kriza politike në Ukrainë dhe trazirat në Lindjen e Mesme e kanë bërë të qartë se BE-ja ka nevojë për një politikë të fortë të përbashkët të jashtme.

BE-ja është lojtar kyç në çështjet e shumta të politikës së jashtme, duke filluar nga programi bërthamor i Iranit dhe stabilizimi i "Horn of Africa", deri tek ngrohja globale. Politika e saj e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, e projektuar për zgjidhjen e konflikteve dhe për nxitjen e mirëkuptimit ndërkombëtar, është e bazuar në diplomaci, ndërsa tregtia, ndihma, siguria dhe mbrojtja, të gjitha këto luajnë një rol plotësues. Si donatori më i madh në botë i financimit të zhvillimit, BE-ja në mënyrë të veçantë është e vendosur për bashkëpunim me vendet në zhvillim. BE-ja gjithashtu merret me tema si mjedisi, arsimiti, lufta kundër krimit dhe të drejtat e njeriut në marrëdhëniet e saj me pjesën tjetër të botës.

Aktualisht, BE-ja është duke u përqendruar në mbështetjen e procesit të reformave gjithëpërfshirëse që është në ecuri/zhvillim e sipër në Ukrainë, sidomos përmes zbatimit të një pakete mbështetëse të paparë prej 11 miliardë euro. Kundruall sfondit të krizës në Ukrainën lindore, BE-ja mbështet të gjitha përpjekjet për të krijuar një zgjidhje të qëndrueshme paqësore.


Kriza siriane është bërë katastrofa më e rëndë humanitare dhe e sigurisë në botë. BE-ja dhe vendet përbërëse të saj udhëheqin reagimin ndërkombëtar. Si donatori më i madh, ato kanë mobilizuar më shumë se 4 miliardë euro për zhvillim dhe ofrimin e ndihmës humanitare që nga fillimi i konfliktit.

Politika e jashtme dhe e sigurisë e BE-së është zhvilluar gradualisht gjatë shumë viteve dhe i mundëson BE-së të flasë dhe të veprojë si një, për çështjet botërore. Duke vepruar së bashku, 28 shteteve anëtare të BE-së i ofrohet më shumë autoritet se sa ata mund të kenë nëse ndjekin secili politikat e veta. Pësha absolute demografike dhe ekonomike e bllokut të 28 vendeve, e bën atë një fuqi të madhe. Është tregtari më i madh në botë, me valutën e dytë më të madhe në botë, euron. Prirja drejt vendimeve të përbashkëta të politikës së jashtme forcon edhe më tej pozicionin e saj.

BE-ja ka partneritet me të gjithë aktorët kyç botërorë, përfshirë fuqitë në zhvillim. Synon të sigurohet se këto marrëdhënie janë të bazuara në interesa dhe përfitime të përbashkëta, me të drejta dhe detyra për të dyja anët. Objektivat aktuale të Komisionit përfshijnë:

- krijimi i më shumë sinergjive në mes të shteteve anëtare në prokurimin e mbrojtjes;
- sjellja e paqes dhe stabilitetit në fqinjësinë evropiane duke vazhduar negociatat e zgjerimit, veçanërisht me vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo do të marrë shumë kohë, kështu që nuk është paraparë zgjerimi i mëtejshëm gjatë mandatit të Komisionit të Juncker (d.m.th. para përfundimit të vitit 2019);
- tërheqja e kapaciteteve të mbrojtjes nga ato qeveri kombëtare që dëshirojnë ta bëjnë këtë, duke mundur që ata të marrin pjesë në misionet e përbashkëta të BE-së dhe duke shmangur në këtë mënyrë dyfishimin e programeve dhe kursimin e të hollave.

PJESËMARRJA E BE-SË NË EKONOMINË BOTËRORE



Edhe pse BE-ja e ka vetëm rreth 7% të popullsisë së botës, pjesëmarrja e saj ekonomike llogaritet për më shumë se 24% të BPV-së botërore.

Union i ndryshimit demokratik

Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të perceptimit që pasqyrohet në rezultatet e zgjedhjeve Evropiane, që BE-ja është e distancuar nga njerëzit e saj dhe është tepër burokratike. Qytetarët presin që BE-ja të bëjë ndryshime në sferat e rëndësishme ekonomike dhe sociale. Programet e punës së Komisionit të Juncker-it pasqyrojnë këtë duke ulur ndjeshëm numrin e iniciativave të reja, heqjen e disa propozimeve të mëhershme për ligjet e reja dhe rishqyrtimin e ligjeve ekzistuese

Komisioni është i angazhuar për demokraci dhe reformë.

Objektivat kryesorë të tij përfshijnë:

- propozimin e ligjeve të reja vetëm atëherë kur nevojiten dhe ofrimin e një vlere të qartë të shtuar evropiane pas konsultimit me publikun. Programi i punës i vitit 2015 përfshinë 23 iniciativa të reja;
- duke qenë plotësisht transparent për atë se çfarë është duke bërë Komisioni (për shembull, komisionerët dhe zyrtarët e lartë publikojnë detajet e takimeve të tyre: transparencë e paparë është inkurajuar për negociatat e tregtisë ndërkombëtare);
- shqyrtimin e ligjeve ekzistuese dhe përshtatjen e tyre kur është e nevojshme;
- heqjen e 'shiritit të kuq' (burokracisë) së panevojshme në nivel evropian dhe kombëtar;
- krijimin e një regjistri të detyrueshëm për organizatat dhe individët që llojnë tek Komision, Parlamenti dhe Këshilli;
- gjetja e mënyrave për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve kombëtare dhe të Komisionit.

Që nga dhjetori i vitit 2014, komisionerët, anëtarët e kabineteve të tyre dhe drejtorët e përgjithshëm të Komisionit duhet t'i publikojnë datat, vendet, emrat e organizatave dhe individëve të vetëpunësuar që ata takojnë, si dhe temat e diskutimit të tyre. Kjo për arsye se është po aq e rëndësishme që t'i mundësohet qytetarit të dinë se kë takon Komisioni dhe pse i takon Komisionit ta mbajë dialogun të hapur dhe të rregullt me palët e interesit.

Në maj të vitit 2015, Komisioni Evropian miratoi agjendën e saj më të mirë rregullatore. Kjo ka për qëllim të sigurojë:

- transparencë gjatë përgatitjes, zbatimit dhe rishikimit të politikave;
- se dëshmitë gjithmonë informojnë politikëbërjen;
- se çdokush i ndikuar nga propozimet është i përfshirë, duke përfshirë gjithashtu edhe anëtarë nga publiku.

Komisioni do të hapë procesin e politikëbërjes për të çuar përpara shqyrtimin publik dhe inputet, me konsultime të reja publike kur bëhet fjalë për vlerësimin e propozimeve të reja ose vlerësimin e politikave ekzistuese. Do të ketë mundësi të reja për komente publike gjatë gjithë

NUMRI I LIGJEVE TË REJA TË BE-SË TË PROPOZUARA NGA KOMISIONI



* Numri i vogël i iniciativave për shkak të zgjedhjeve Evropiane në maj

Komisioni është përqëndruar në një numër të vogël të prioritetëve

procedurës së hartimit të ligjit. Pasi që Komisioni të ketë miratuar propozimin, çdo qytetar i interesuar do të ketë 8 javë kohë që të ofrojë reagimin e tij kthyes ose sugjerimet të cilat do të inkorporohen në debatin legjislativ para Parlamentit dhe Këshillit.

Ligjet ekzistuese do të vlerësohen, pjesërisht përmes qëndrueshmërisë rregullatore dhe programit të realizimit (REFIT). Kjo bënë vlerësimin e legjislacionit ekzistues për ta bërë atë më efektiv dhe më efikas pa komprometuar objektivat e politikës. Komisioni tashmë është duke punuar për reduktimin e barrës për biznese në fushat e tilla si tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), prokurimi publik, statistikën e biznesit dhe kimikatet. Vlerësime të përgjithshme në fushat e tjera janë gjithashtu në proces e sipër.

Për më tepër, Komisioni gjithashtu është duke ripërtërirë angazhimin në dëgjimin e pikëpamjeve të çdo pale të interesuar në çfarëdo kohe me anë të një mjeti që është në dispozicion në internet dhe që quhet '**Lighten the Load — Have Your Say (Lehtësoje barrën - thuaje fjalën tënde)**.'

Kontaktioni me BE-në



■ PËRMES INTERNETIT

Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian janë në dispozicion në faqen e internetit të Evropës **www.europa.eu**



■ PERSONALISHT

Në gjithë Evropën ka qindra lokale informative të BE-së
Ju mund të gjeni adresën e qendrës më të afërt në **www.europedirect.europa.eu**



■ NË TELEFON OSE PËRMES POSTËS

Europe Direct është një shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja në lidhje me Bashkimin Evropian.

Ju mund të kontaktoni këtë shërbim përmes telefonit pa pagesë: **00 800 6 7 8 9 10 11** (disa operator

të caktuar të telefonisë mobile nuk lejojnë qasjen në numrat 00 800 ose mund të ju ngarkojnë me pagesë për këto thirrje **+32 22999696** ose me e-mail nëpërmjet **www.europedirect.europa.eu**



■ LEXONI NË LIDHJE ME EVROPËN

Publikimet në lidhje me Evropën janë vetëm një klik larg në librarinë e BE-së në faqen e internetit **www.bookshop.europa.eu**

Poashtu informatat dhe doracakët rreth BE-së në gjuhën angleze mund ti merrni nga :

PËRFAQËSITË E KOMISIONIT EVROPIAN

Përfaqësia e Komisionit Evropian në Irlandë

12-14 Lower Mount Street,
Dublin 2,
IRLANDË
Tel. +353 16341111
Internet: <http://www.ec.europa.eu/ireland>
Email: eu-ie-info-request@ec.europa.eu

Përfaqësia e Komisionit Evropian në Mbretërinë e Bashkuar

Europe House
32 Smith Square
Londër SW1P 3EU
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 2079731992
Internet: <http://www.ec.europa.eu/uk>

Zyra e Komisionit Evropian në Irlandën Veriore

74-76 Dublin Road
Belfast BT2 7HP
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 2890240708
Internet: <http://www.ec.europa.eu/uk>

Zyra e Komisionit Evropian në Skotlandë

9 Alva Street
Edinburgh EH2 4PH
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 1312252058
Internet: <http://www.ec.europa.eu/uk>

Zyra e Komisionit Evropian në Wales

2 Caspian Point, Caspian Way
Cardiff CF10 4QQ
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 2920895020
Internet: <http://www.ec.europa.eu/uk>

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shtetet e Bashkuara

2175 K Street, NW
Washington DC 20037
SHTETET E BASHKUARA
Tel. +1 2028629500
Internet: <http://www.eurunion.org>

ZYRAT INFORMATIVE TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Zyra Informative në Irlandë

12-14 Lower Mount Street
Dublin 2
IRLANDË
Tel. +353 16057900
Internet: <http://www.europarl.ie>
Email: epdublin@ec.europa.eu

Zyra Informative në Mbretërinë e Bashkuar

Europe House
32 Smith Square
Londër SW1P 3EU
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 2072274300
Internet: <http://www.europarl.org.uk>
Email: epLondër@europarl.europa.eu

Zyra Informative në Skotlandë

The Tun, 4 Jackson's Entry
Holyrood Road
Edinburgh EH8 8PJ
MBRETËRIA E BASHKUAR
Tel. +44 1315577866
Internet: <http://www.europarl.org.uk>
Email: epedinburgh@europarl.europa.eu

Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian ka përfaqësi dhe zyra të Komisionit dhe Parlamentit Evropian. Bashkimi Evropian gjithashtu ka delegacione në pjesët e tjera të botës

Bashkimi Evropian



Dhjetë prioritete për Evropën

Agjendë e BE-së për punësim,
zhvillim, drejtësi dhe ndryshime
demokratike

Mësoni më shumë

- ▶ Dhjetë prioritetet e Komisionit Evropian: http://ec.europa.eu/priorities/index_en.htm
- ▶ Pyetje në lidhje me Bashkimin Evropian Europe Direct mund të ndihmojë 00 800 6 7 8 9 10 11 <http://europedirect.europa.eu>

